



**REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT**  
**AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE**

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 22 dhe neni 20 paragrafi (1) nënparagrafët 1 dhe 10<sup>1</sup> të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20, 77/21 dhe 154/23), dhe në pajtim me nenin 54 paragrafi (4) dhe neni 104 paragrafi (4) të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.124/15), në lidhje me Propozimin PA1 nr.08-331 datë 05.10.2023, Aktvendimin PA1 nr.08-331 datë 17.10.2023 për vazhdimin e afatit për vendimarrje pas procedurës së iniciuar për heqjen e lejes, Raporti me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore nr.10-4176/1, datë 10.11.2023, dhe Propozimin PA1 nr.08-331, datë 14.11.2023, dhe në pajtim me Konkluzionin, ark.nr.02-4225/2 datë 16.11.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 37-të mbajtur më 16.11.2023, miratoi:

**Aktvendim**  
**për ndalim të procedurës së iniciuar për heqje**  
**të lejes për transmetim në radio**

NDALEHET procedura e iniciuar për heqjen e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive (SHTR) Radio KANAL 77 SHPKNJP Shtip, nr 08-64 datë 05.01.2015, vazhduar me Vendim, PA1 nr. 08-258 datë 15.08.2023 .

**A r s y e t i m**

Këshilli i Agjencisë në seancën e 32-të mbajtur më 09.10.2023, me konkluzionin ark.nr.02-3637/3 datë 09.10.2023, miratoi propozimin e drejtorit të Agjencisë, dr.Zoran Trajčevski, PA1 nr.08-331 datë 05.10.2023, dhe inicioi procedurë për heqjen e lejes për transmetim në radio të SHTR Radio KANAL 77 SHPKNJP Shtip, PA1 nr.08-64, datë 05.01.2015, vazhduar me Vendim nr.08-258, datë 15.08.2023, për faktin se pas mbikëqyrjes së jashtëzakonshme programore, në Raportin me shkrim ark.nr.10-3676/1, datë 05.10.2023, është konstatuar se transmetuesi më 6 shtator 2023, nuk ka ofruar transmetimin e një shërbimi të vetëm programor në tërësi të programeve të transmetuara dhe elementëve të tjerë të një shërbimi të vetëm audio mediatik të destinuar për pranimit nga publiku në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me këtë është shkëlur neni 68, dhe në neni 3 paragrafi (1) pika 12 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV).

Lidhur me këtë, nga ana e Agjencisë me datë 09.10.2023, drejtuar transmetuesit të lartpërmendur i është dërguar Shkresë PA1 nr. 08-331 datë 09.10.2023, për njoftim se nëse menjëherë nuk e harmonizon punën e tij me LSHMAAV, d.m.th nëse nuk i heq pengesat e konstatuara ligjore për kryerjen e veprimtarisë, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për fillimin e procedurës për heqjen e lejes, do të sjellë vendim për heqjen e lejes për transmetim në radio.

Në bazë të nenit 83 paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli është i obliguar që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të propozimit të drejtorit për fillimin e

PA1 Nr. 08-331

Shkup 17 .11.2023.



**Agjencia për**  
**Shërbime Mediatike**  
**Audio dhe**  
**Audiovizuele**

rr. Makedonija nr.38  
1000 Shkup  
Republika e  
Maqedonisë së Veriut

tel. + 389 2 3103 400

[www.avmu.org.mk](http://www.avmu.org.mk)  
[www.avmu.mk](http://www.avmu.mk)  
[contact@avmu.mk](mailto:contact@avmu.mk)





**REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT**  
**AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE**

---

procedurën për heqjen e lejes, të sjellë vendim me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshilli, pra për procedurën e inicuar në fjalë jo më vonë se 19.10.2023.

Megjithatë, më 13.10.2023 Sektori për Çështjet Programore i ka dorëzuar Drejtorit të Agjencisë Njoftimin nr.10-3676/2 datë 13.10.2023 në të cilin thuhej se është e nevojshme të kryhet mbikëqyrje tjetër e jashtëzakonshme programore për të kontrolluar nëse transmetuesi ka hequr pengesat ligjore për kryerjen e veprimtarisë dhe kjo nëpërmjet një analize krahasuese të strukturës programore të shërbimit programor të SHTR Radio KANAL 77 SHPKNJ Shtip që transmetohet nëpërmjet frekuencave të shumta që i shfrytëzon transmetuesi për të mbuluar tërë territorin e vendit, që nënkupton organizimin e regjistrimit, dëgjimit, analizimit dhe regjistrim të duhur të çdo sekonde të programit të transmetuar. Vetë analiza krahasuese pas marrjes së regjistrimeve nga programi, për shkak të kompleksitetit, thuhet se do të zgjasë shumë më gjatë se mbikëqyrjet e tjera programore të kryera nga Agjencia, kështu që sektori kompetent raportoi se nuk ka kushte që kjo mbikëqyrje të përfundojë (kryhet) para afatit në të cilin Këshilli i Agjencisë duhet të sjellë vendimin pas procedurës së inicuar.

Me rastin e Njoftimit të përmendur, Drejtori i Agjencisë i dorëzoi Këshillit të Agjencisë Propozimin PA1 nr.08-331 nga data 13.10.2023, për marrjen e aktvendimit për vazhdimin e afatit për marrjen e vendimit pas procedurës së inicuar për heqjen e lejes. Lidhur me këtë, Këshilli i Agjencisë në seancën e 33-të mbajtur më 16.10.2023, në pajtim me Konkluzionin nr.02-3741/2, datë 17.10.2023, miratoi Akvendim PA1 nr.08-331, datë 17.10.2023, për vazhdimin e afatit për marrjen e vendimit pas procedurës së inicuar për heqjen e lejes, jo më gjatë se 30 (tridhjetë) ditë, për shkak të kompleksitetit të lëndës, përkatësisht specifikave të mbikëqyrjes së jashtëzakonshme programore që duhet të kryhen për të kontrolluar nëse transmetuesi ka hequr pengesat ligjore për kryerjen e veprimtarisë.

Më datë 10.11.2023, Sektori për Çështje Programore i ka dorëzuar Drejtorit të Agjencisë Raport me shkrim për mbikëqyrjen e krye të kontrollit programor nr. 10-4176/1 datë 10.11.2023, ku ndër të tjera thuhet se më 19 tetor 2023, SHTR Radio KANAL 77 SHPKNJ Shtip ka transmetuar një shërbim të vetëm programor në tërësi të programeve të transmetuara dhe elementëve të tjerë të një shërbimi të vetëm audio mediatik të destinuar për praninë nga publiku përmes tre frekuencave të analizuara që ai shfrytëzon për mbulimin e zonës për të cilën i është dhënë leja, si dhe ka hequr pengesat e parashikuara me ligj për kryerjen e veprimtarisë, pra ka vepruar plotësisht sipas Njoftimit ark.nr.08-331 datë 09.10.2023.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 22 dhe neni 20 paragrafi (1) nënparagrafët 1 dhe 10 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në pajtim me nenin 54 paragrafi (4) dhe nenin 104 paragrafi (4) të ligjit për procedurën e përgjithshme administrative, lidhur me Propozimin PA1 nr.08-331, datë 05.10.2023, Aktvendimin PA1 nr.08-331, datë 17.10.2023 për vazhdimin e afatit për vendimarrje pas procedurës së inicuar për heqjen e lejes, Raporti me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore nr.10-4176/1, datë 10.11.2023, dhe Propozimin PA1 nr.08-331 datë 14.11.2023, dhe në pajtim me Konkluzionin ark.nr.02-4225/2 datë 16.11.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e 37-të mbajtur më 16.11.2023, vendosi ndërprerjen e procedurës së inicuar për heqjen e lejes.

Bazuar në sa më sipër u mor vendim si në dispozitiv.

---

<sup>1</sup> Paragrafët 8 dhe 9 fshihen, shih nenin 8 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 248/18).



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT  
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

---

Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuele  
Kryetari i Këshillit,  
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.

**Këshillë juridike** : Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.